13. Kryesimi i mbledhjeve të drejtorëve	5
14. Transaksionet ose marrëveshjet me shoqërinë	5
15. Konflikti i interesit	5
16. Mbajtja e regjistrave të vendimeve	7
17. Diskrecioni i drejtorëve për të nxjerrë rregulla të mëtejshme	7
18. Ndryshimi i emrit	7
19. Mënyra e emërimit të drejtorëve	7
20. Mbarimi i mandatit të drejtorit	7
21. Emërimi dhe shkarkimi i drejtorëve nga aksionarët e shumicës	8
22. Paga e drejtorëve	8
23. Shpenzimet e drejtorëve	8
Pjesa 3 - Aksionet dhe Shpërndarjet	9
24. Të gjitha aksionet shlyhen plotësisht	9
25. Tagri për të emetuar klasa të ndryshme aksionesh me të drejta të ndryshme	9
26. Certifikatat e aksioneve	9
27. Transferimi i aksioneve	10
28. Procedura për deklarimin e dividendëve	10
29. Shpërndarjet jo-cash	10
30. Shpërndarja e fitimit të gatshëm në rastin e prishjes së shoqërisë	10
31. Tagri për të kapitalizuar dhe shpërndarja e shumave të kapitalizuara	11
Pjesa 4 - Vendimmarrja nga aksionarët	11

32. Kufizimi i efektit të kësaj pjese 4	11
33. Vendimet e aksionarëve	11
34. Vendimet me shkrim	12
35. Vendimet me shkrim të propozuara nga drejtorët	12
36. Vendimet me shkrim të propozuara nga anëtarët	12
37. Vendimet në mbledhjen e anëtarëve	12
Pjesa 5 - Rregullat administrative	13
38. Mjetet komunikimit që përdoren	13
39. Vula e shoqërisë dhe nënshkrimi i dokumenteve	14
40. Ndalimi i të drejtës për të inspektuar librat dhe regjistrat kontabël	14
41. Provigjonet për punëmarrësit në rastin e prishjes së shoqërisë	14
42. Dëmshpërblimi dhe shpenzimet	14

Pjesa 1

Interpretimi dhe Kufizimi i Përgjegjësisë

1. Përkufizimi i termave

Në këtë statut, me përjashtim të rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe:

"**Ligj**" është Ligji për Shoqëritë i vitit 2006;

"**statut**" është statuti i shoqërisë;

"**falimentim**" përfshin procedurat individuale të likuidimit në një juridiksion të ndryshëm nga Anglia dhe Uells ose nga Irlanda Veriore, që kanë efekt të ngjashëm me falimentimin;

"**kryetar**" ka kuptimin që i jepet në nenin 13;

"**Ligji për Shoqëritë**" është Ligji për Shoqëritë (i përkufizuar në seksionin 2 të Ligjit), në masën që është i zbatueshëm për shoqërinë;

"**drejtor**" është drejtori i shoqërisë, dhe përfshin çdo person që mban postin e drejtorit, me çfarëdo emërtim;

"**marrës i shpërndarjes**" ka kuptimin që i jepet në nenin 29;

"**dokument**" përfshin, nëse përcaktohet ndryshe, çdo dokument të dërguar ose të paraqitur elektronikisht;

"**elektronikisht**" ka kuptimin që i jepet në seksionin 1168 të Ligjit;

"**anëtarët e kualifikuar**" ka kuptimin që i jepet në seksionin 289 të Ligjit;

"**i paguar plotësisht**" në lidhje me një aksion, do të thotë që vlera nominale dhe çdo prim që duhet t'i paguhet shoqërisë në lidhje me atë aksion, i është paguar plotësisht shoqërisë;

"**shoqëri e grupit**" është shoqëria që ka pronësinë ose kontrollin e fundit mbi shoqërinë (nëse ka) dhe çdo subjekt që është drejtpërdrejtë ose tërthorazi në pronësi të plotë të shoqërisë ose të shoqërisë që ka kontrollin e fundit, herë pas here për secilin rast;

"**formë shkresore**" ka kuptimin që i jepet në seksionin 1168 të Ligjit;

"**zotërues**" në lidhje me aksionet është personi emri i të cilit është i regjistruar në regjistrin e anëtarëve si zotërues i aksioneve;

"**instrument**" është dokumenti në formë shkresore;

"**vendim i zakonshëm**" ka kuptimin që i jepet në seksionin 282 të Ligjit;

"**i paguar**" do të thotë i paguar ose i kredituar si i paguar;

"**pjesëmarrje**", në lidhje me mbledhjen e drejtorëve, ka kuptimin që i jepet në nenin 11;

"**vendim**" përfshin një vendim të zakonshëm dhe një vendim të jashtëzakonshëm (sipas përkufizimit në nenin 33) nëse nuk përcaktohet ndryshe;

"**aksionar**" është personi që zotëron një aksion;

"**aksione**" janë aksionet e shoqërisë;

"**vendim i jashtëzakonshëm**" ka kuptimin që i jepet në seksionin 283 të Ligjit;

"**degë**" ka kuptimin që i jepet në seksionin 1159 të Ligjit;

"**me shkrim**" është paraqitja ose riprodhimi i fjalëve, simboleve ose informacioneve të tjera në formë vizive përmes çdo metode apo kombinimi metodash, qoftë nëse dërgohet elektronikisht apo në forma të tjera.

Nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, fjalë apo shprehje të tjera të përdorura në këtë statut kanë të njëjtin kuptim që u jepet në Ligjin në fuqi në datën kur ky statut ka hyrë në fuqi dhe është bërë detyrues për shoqërinë.

Termi "duke përfshirë" ose "përfshin" nuk e kufizon fushën e kuptimit që fjalëve që i paraprijnë atij.

2. Rregullat e shoqërisë

Ky statut është statuti i shoqërisë dhe Modeli i Statutit për Shoqëritë Private me Përgjegjësi të Kufizuar në Ligjin për Shoqëritë të vitit 2006 Model nuk zbatohet.

3. Përgjegjësia e anëtarëve

Përgjegjësia e anëtarëve kufizohet deri në pjesën e pashlyer, nëse ka, të aksioneve të zotëruara prej tyre në shoqëri.

Pjesa 2

Drejtorët

Tagri dhe përgjegjësitë e Drejtorëve

4. Tagri i përgjithshëm i Drejtorëve

Në zbatim të këtij statuti, drejtorët janë përgjegjës për administrimin e aktivitetit të shoqërisë, dhe në këtë funksion ata mund të ushtrojnë të gjitha tagrat e shoqërisë.

5. Tagri rezervuar aksionarëve

- 5.1 Aksionarët mundën që me vendim të jashtëzakonshëm të udhëzojnë drejtorët të ndërmarrin ose të mos ndërmarrin një veprim specifik.
- 5.2 Vendimi i jashtëzakonshëm në këtë rast nuk i bën të pavlefshme veprimet që drejtorët kanë ndërmarrë përpara miratimit të vendimit në fjalë.

6. Delegimi nga drejtorët

- 6.1 Në zbatim të këtij statuti, drejtorët mund të delegojnë çdo tagër dhe kompetencë të tyre që u është dhënë sipas statutit-
 - (a) te ata persona ose komitete;
 - (b) me ato mjete (përfshirë me prokurë të posaçme);
 - (c) deri në atë masë;
 - (d) në lidhje me ato çështje ose territore; dhe
 - (e) sipas atyre kushteve; që ata gjykojnë si të përshtatshme.
- 6.2 Nëse përcaktohet nga drejtorët, çdo delegim i tillës mund të autorizojë delegimin e mëtejshëm të tagrit të drejtorëve nga personat të cilëve u është deleguar.
- 6.3 Drejtorët mund të revokojnë delegimin tërësisht apo pjesërisht, ose të ndryshojnë kushtet e tij.

7. Komitetet

- 7.1 Komitetet të cilat drejtorët delegojnë tagrin e tyre, duhet të ndjekin procedura që bazohen deri në masën e zbatueshme në ato dispozita të statutit që rregullojnë marrjen e vendimeve nga drejtorët.
- 7.2 Drejtorët mund të përgatisin rregulloren e brendshme për të gjitha komitetet dhe këto rregullore kanë përparësi ndaj rregullave të përcaktuara në statut, në rast mospërputhjeje mes tyre.

Vendimmarrja nga Drejtorët

8. Drejtorët marrin vendime bashkërisht

- 8.1 Rregulli i përgjithshëm për vendimmarrjen nga drejtorët është që vendimi i drejtorëve ose duhet të jetë vendim shumice i marrë në mbledhje, ose vendim shumice i marrë në përputhje me nenin 9.
- 8.2 Ky statut nuk ndikon në vlefshmërinë e vendimeve të marra në përputhje me nenin 12.

9. Vendimet me shkrim të Drejtorëve

- 9.1 Vendimi me shkrim i drejtorëve merr formën e rezolutës me shkrim që është qarkulluar te çdo drejtor i kualifikuar dhe për të cilin
- (a) kur përmbushen të dyja kushtet e përcaktuara në nenin 9.4, shumica e drejtorëve të kualifikuar; ose
 - (b) kur njëri apo të dy kushtet e përcaktuara në nenin 9.4 nuk përmbushen, të gjithë drejtorët e kualifikuar ka shprehur miratimin e tyre me shkrim.
- 9.2 “Me shkrim” në këtë statut është paraqitja ose riprodhimi i fjalëve, simboleve ose informacioneve të tjera në formë vizive përmes çdo metode apo kombinimi metodash, qoftë nëse dërgohet elektronikisht apo në forma të tjera.
- 9.3 “Drejtorët e kualifikuar” në këtë statut janë drejtorët që do të kishin votuar mbi çështjen përkatëse nëse ajo do të ishte propozuar për vendimmarrje në mbledhjen e drejtorëve.
- 9.4 Kushtet e përmendura në nenin 9.1 janë që:
- (a) Drejtorët e kualifikuar do të kishin formuar një kuorum në mbledhjen e drejtorëve; dhe
 - (b) Drejtorët e kualifikuar janë katër ose më shumë në numër.

10. Thirrja e mbledhjes së drejtorëve

- 10.1 Çdo drejtor mund të thërrasë një mbledhje drejtorësh duke:
- (a) dhënë njoftim për mbledhjen te çdo drejtor; ose
 - (b) duke autorizuar sekretarin e shoqërisë (nëse ka) të japë njoftim për mbledhjen te çdo drejtor.
- 10.2 Njoftimi i mbledhjes së drejtorëve duhet të jepet të paktën 48 orë përpara mbledhjes (përveçse kur drejtorët bien dakord ndryshe) dhe mund të dërgohet me faks, me email ose me çdo formë tjetër të shkruar.

- 10.3 Në çdo njoftim mbledhjeje që i dërgohet drejtorëve duhet të cilësohet:
- (a) data dhe ora e propozuar e mbledhjes;
 - (b) vendi i mbajtjes së mbledhjes; dhe
 - (c) nëse parashikohet që drejtorët pjesëmarrës në mbledhje nuk do të jenë të pranishëm në të njëjtin vend, propozimi për mënyrën sesi ata do të komunikojnë me njëri-tjetrin gjatë mbledhjes.
- 10.4 Drejtorët mund të heqin dorë nga e drejta e tyre për të marrë njoftime për mbledhjet, duke njoftuar shoqërinë:
- (a) përpara mbajtjes së mbledhjes;
 - (b) gjatë mbledhjes; ose
 - (c) jo më shumë se 7 ditë pasi është mbajtur mbledhja, se ata kanë hequr dorë nga kjo e drejtë.
- 10.5 Kur ky njoftim jepet pasi është mbajtur mbledhja, kjo nuk ndikon në vlefshmërinë e mbledhjes, as në rendin e ditës të zhvilluar gjatë asaj mbledhjeje.

11. Pjesëmarrja në mbledhjet e drejtorëve

- 11.1 Në zbatim të këtij statuti, drejtorët marrin pjesë në mbledhjet e drejtorëve, ose në një pjesë të mbledhjes së drejtorëve, kur:
- (a) mbledhja është thirrur dhe mbahet në përputhje me statutin, dhe
 - (b) secili prej tyre mund të komunikojnë me njëri-tjetrin për informacione ose opinione që ata kanë mbi çështje të caktuara të rendit të ditës së mbledhjes (përfshirë me video konferencë ose me telekonferencë).
- 11.2 Për konstatimin e pjesëmarrjes së drejtorëve në mbledhje, nuk ka rëndësi vendi nga ku po marrin pjesë drejtorët apo mënyra sesi ata po komunikojnë me të tjerët.
- 11.3 Nëse të gjithë drejtorët pjesëmarrës në mbledhje nuk janë në të njëjtin vend, ata mund të vendosin që mbledhja të konsiderohet se është zhvilluar në vendndodhjen e secilit prej tyre.

12. Kuorumi për MBLEDHJET E DREJTORËVE

- 12.1 Në një mbledhje drejtorësh nëse nuk arrihet kuorumi i nevojshëm nuk mund të votohet asnjë propozim, përveç propozimit për të thirrur një mbledhje tjetër.
- 12.2 Kuorumi i mbledhjeve të drejtorëve mund të përcaktohet herë pas here me vendim të drejtorëve, por ai nuk mund të jetë asnjëherë më pak se 1/3 e numrit të drejtorëve, dhe nëse nuk përcaktohet ndryshe, ai është 3.
- 12.3 Për sqarim, nëse kuorumi për mbledhjet e drejtorëve në një moment të caktuar është vendosur të jetë një, dhe vetëm një drejtor voton për propozimin, atëherë me kusht që mbledhja të jetë mbajtur rregullisht dhe propozimi të jetë përcaktuar në njoftimin për mbajtjen e mbledhjes, atëherë vendimi i drejtorët është i vlefshëm dhe konsiderohet si vendim i drejtorëve i marrë në një mbledhje drejtorësh të mbledhur dhe të kuoruar rregullisht.

- 12.4 Nëse numri total i drejtorëve në një moment të caktuar në kohë, është më pak se kuorumi i nevojshëm, atëherë drejtorët nuk duhet të marrin vendime, përveç vendimit-
- (a) për të emëruar drejtorë të tjerë, ose
 - (b) për të thirrur një mbledhje të përgjithshme me qëllimin që t'u jepet mundësia aksionarëve të emërojnë drejtorë të tjerë.

13. Kryesimi i mbledhjeve të drejtorëve

- 13.1 Drejtorët mund të emërojnë një drejtor për të kryesuar mbledhjet e tyre.
- 13.2 Ky person i emëruar për kohëzgjatjen e këtij emërimi njihet si kryetari.
- 13.3 Drejtorët mund të shkarkojnë kryetarin në çdo kohë.
- 13.4 Nëse kryetari nuk merr pjesë në mbledhjen e drejtorëve brenda dhjetë minutave nga ora në të cilën ajo ka filluar, atëherë drejtorët pjesëmarrës mund të caktojnë një drejtor nga të pranishmit për të kryesuar mbledhjen.

14. Transaksionet ose marrëveshjet me shoqërinë

Në zbatim të seksioneve 177(5) dhe 177(6) dhe seksioneve 182(5) dhe 182(6) të Ligjit dhe me kusht që ai të ketë deklaruar natyrën dhe shkallën e interesit të tij/saj në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë, një drejtor

- (a) mund të jetë palë, ose të mbajë interesa, në një kontratë, transaksion ose marrëveshje me shoqërinë ose në të cilën shoqëria (drejtpërdrejtë ose tërthorazi) është e interesuar ("Çështje e Rëndësishme");
- (b) ka të drejtë të votojë për çdo vendim të propozuar të drejtorëve (ose të komitetit të drejtorëve) në lidhje me Çështjen e Rëndësishme ose Çështjen e Rëndësishme të propozuar, për të cilën ai/ajo është i/e interesuar;
- (b) ka të drejtë të votojë në mbledhjen e drejtorëve (ose të komitetit të drejtorëve) ose të marrë pjesë në vendimet me shkrim të drejtorëve, në lidhje me Çështjen e Rëndësishme ose Çështjen e Rëndësishme të propozuar, për të cilën ai/ajo është i/e interesuar;
- (d) mund të veprojë në emrin e tij/saj ose të firmës së tij/saj në një kapacitet profesional për shoqërinë (jo si auditues) dhe ai/ajo ose firma e tij/saj gëzojnë të drejtën të shpërblehen për shërbimin profesional, sikur ai/ajo të mos ishin drejtor;
- (e) mund të jetë drejtor ose nëpunës tjetër i, ose i punësuar nga, ose palën në një transaksion ose marrëveshje me, ose i interesuar në, çdo subjekt në të cilin shoqëria është e interesuar (drejtpërdrejtë ose tërthorazi); dhe
- (f) nuk mban përgjegjësi ndaj shoqërisë, përveçse kur bie dakord vet, për përfitime që ai/ajo (ose një person i lidhur me të (sipas përkufizimit në seksionin 252 të Ligjit)) merr nga Çështja e Rëndësishme ose nga çdo post apo punësim apo formë tjetër interesi në një subjekt, dhe Çështja e Rëndësishme nuk mund të shmanget për arsye të këtij interesi apo përfitimi, dhe marrja e shpërblimit apo përfitimit nuk përbën shkelje të detyrës prej tij/saj të seksionit 176 të Ligjit.

15. Konflikti i Interesit

15.1 Në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë statut, drejtorët mund të autorizojnë çdo çështje apo situatë që u propozohet nga çdo drejtor, që nëse nuk autorizohet, do të bënte që ky drejtor ("Drejtori i Interesuar") të kryente shkelje të detyrës sipas seksionit 175 të Ligjit për shmangur konfliktin e interesit ("Konfliktet").

Çdo autorizim sipas këtij neni 15, do të ketë efekt vetëm nëse:

- (a) çështja në fjalë do të ishte propozuar nga çdo drejtor për shqyrtim në të njëjtën mënyrë si çdo çështje tjetër që mund t'u propozohet drejtorëve sipas dispozitave të statutit ose në çdo mënyrë tjetër që mund të vendoset nga drejtorët;
- (b) çdo kërkesë për kuorumin për shqyrtimin e çështjes së rëndësishme përmbushet pa llogaritur Drejtorin e Interesuar; dhe
- (c) çështja miratohet pa votën e Drejtorit të Interesuar ose do të ishte miratuar edhe vota e Drejtorit të Interesuar nuk do të ishte llogaritur.

15.2 Çdo autorizim i një Konflikti sipas këtij neni 15 (qoftë në momentin e dhënies së autorizimit ose më pas) mund:

- (a) të shtrijë efektet të çdo konflikt interesi ekzistues ose i mundshëm, që në mënyrë të arsyeshme pritet të lindë nga çështja ose situata e autorizuar;
- (b) të parashikojë që Drejtori i Interesuar të përjashtohet nga marrja e dokumenteve dhe informacioneve lidhur me Konfliktin dhe nga pjesëmarrja në diskutimet lidhur me konfliktin (qoftë në mbledhjet e drejtorëve apo kudo);
- (c) të parashikojë që Drejtori i Interesuar të ketë ose të mos ketë të drejtën për të votuar në lidhje me vendimin e ardhshëm të drejtorëve për çdo rezolutë lidhur me atë Konflikt;
- (d) t'i vendosë Drejtorit të Interesuar çdo kusht tjetër që drejtorët mendojnë si të përshatshëm për qëllime të trajtimit të Konfliktit;
- (e) të lejojë Drejtorin e Interesuar të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjeve lidhur me Konfliktin në çdo mbledhje të drejtorëve dhe të mos marrë pjesë në shqyrtimin e dokumentacionit të përgatitur nga ose për drejtorët në masën që ato kanë lidhje me këto çështje.

15.3 Kur drejtorët autorizojnë një Konflikt, Drejtori i Interesuar do të jetë i detyruar të veprojë në përputhje me termat dhe kushtet e vendosura nga drejtorët në lidhje me Konfliktin.

15.4 Drejtorët mund të revokojnë ose ndryshojnë autorizimin e dhënë në çdo kohë, por kjo nuk ndikon në veprimet e kryera nga Drejtori i Interesuar përpara këtij revokimi apo ndryshimi, në përputhje me kushtet e këtij autorizimi.

15.5 Një Drejtor i Interesuar nuk do të ketë asnjë detyrim ndaj shoqërisë në lidhje me informacione që ai/ajo ka marrë jo në kuadër të pozicionit të tij si drejtor i shoqërisë dhe për të cilat ai/ajo ka detyrime konfidencialiteti ndaj një tjetër personi. Konkretisht, drejtori nuk konsiderohet se ka shkelur detyrimet e përgjithshme që ka ndaj shoqërisë, sipas seksioneve 171 deri në 177 të Ligjit, nëse ai/ajo:

- (a) nuk ia jep këtë informacion drejtorëve ose ndonjë drejtori, nëpunësi apo punëmarrësi të shoqërisë; ose

- (b) nuk e përdor apo shfrytëzon këtë informacion gjatë ushtrimit të detyrave të tij si drejtor.

Gjithsesi në masën që marrëdhënia e tij ose e saj me atë person tjetër përbën konflikt interesi apo konflikt të mundshëm interesi, ky nen zbatohet vetëm nëse ekzistenca e asaj marrëdhënieje është miratuar nga drejtorët sipas këtij neni 15.

- 15.6 Një drejtor nuk është i detyruar, nisur nga pozita e tij si drejtor (apo për shkak të marrëdhënies në mirëbesim të vendosur për faktin që ai është drejtor) që t'i japë llogari shoqërisë për shpërblime, fitime apo përfitime të tjera që ai/ajo gjeneron nga ose në lidhje me marrëdhënien në Konflikt, që është autorizuar nga drejtorët ose nga Shoqëria në mbledhjen e përgjithshme (në çdo rast në zbatim të termave, kufijve ose kushteve që i bashkëlidhen atij autorizimi) dhe në këto kushte ai/ajo nuk do të konsiderohet se ka shmangur kontratën.

16. Mbajtja e regjistrave të vendimeve

Drejtorët sigurohen që shoqëria të mbajë regjistra me shkrim për të paktën 10 vjet nga data e vendimit të regjistruar, të çdo vendimi unanimit ose të shumicës të marrë nga drejtorët.

17. DISKRECIONI I DREJTORËVE PËR TË NXJERRË RREGULLA TË MËTEJSHME

Në zbatim të statutit, drejtorët mund të nxjerrin çdo rregull që e konsiderojnë të përshtatshëm për mënyrën sesi ata do të marrin vendimet, dhe për mënyrën sesi këto rregulla do të regjistrohen ose komunikohen te drejtorët.

18. NDRYSHIMI I EMRIT

Shoqëria mund të ndryshojë emrin me vendim të drejtorëve.

Emërimi i Drejtorëve

19. Mënyra e emërimit të drejtorëve

Çdo person që është i gatshëm të veprojë si drejtor dhe kjo gjë i lejohet me ligj, mund të emërohet si drejtor:

- (a) me vendim të zakonshëm të anëtarëve;
- (b) me vendim të drejtorëve; ose
- (c) me dhënien e njoftimit për emërimin e tij/saj në përputhje me nenin 21.

20. Mbarimi i mandatit të drejtorit

Një person pushon së qeni drejtor menjëherë sapo:

- (a) ai person së qeni drejtor në bazë të dispozitave të Statutit ose i ndalohet me ligj të jetë drejtorë;
- (b) nxirret një urdhër falimentimi ndaj atij personi;
- (c) bëhet një strukturim me kreditorët e atij personi, kryesisht për të shlyer borxhet e atij personi;
- (d) mjeku specialist që po trajton atë person i dërgon opinion me shkrim shoqërisë ku shprehet se ai person është bërë i paaftë fizikisht ose mendërisht për të mbajtur

postin e drejtorit dhe mund të vazhdojë në këtë gjendje për më shumë se tre muaj;

- (e) nisur nga shëndeti mendor i atij personi, gjykata nxjerr një urdhër që tërësisht apo pjesërisht e ndalon atë person të ushtrojë personalisht kompetencat ose të drejtat që i janë dhënë atij personi;
- (f) shoqëria merr njoftim nga drejtori për dorëheqjen e tij nga detyra, dhe kjo dorëheqje miratohet në përputhje me kushtet e saj; dhe
- (g) ai person ka më shumë se gjashtë muaj rresht që mungon, pa lejen e drejtorëve, në mbledhjet e drejtorëve të mbajtura gjatë asaj periudhe, dhe drejtorët vendosin që ai person duhet të pushojë së qeni drejtor;
- (h) njoftimi i shkarkimit të tij/saj jepet në përputhje me nenin 21.

21. Emërimi dhe shkarkimi i drejtorëve nga aksionarët e shumicës

Anëtari (ose anëtarët bashkërisht) që zotëron në momentin përkatës shumicën e vlerës nominale të kapitalit aksionar të emtuar të shoqërisë dhe ka të drejtën të marrë pjesë dhe të votojë në asamblatë e përgjithshme të shoqërisë mundet që me njoftim me shkrim të nënshkruar prej tij ose në emër të tij (ose të anëtarëve bashkërisht) dhe të dërguar në selinë e shoqërisë ose të paraqitur në mbledhjen e drejtorëve ose në asamblatë e përgjithshme të shoqërisë në çdo kohë dhe herë pas here, të emërojë një person në postin e drejtorëve (qoftë për të plotësuar një vend vakant ose si drejtor shtesë) ose të shkarkojë çdo drejtor nga detyra (pavarësisht sesi është emëruar ai/ajo).

22. Paga e drejtorëve

22.1 Drejtorët mund të kryejnë për shoqërinë çdo shërbim që drejtorët vendosin dhe shoqëria mund të lidhë kontratë shërbimi me secilin drejtor, sipas kushteve që drejtori konsideron të përshtatshme.

22.2 Drejtorët kanë të drejtë të marrin shpërblimin që përcaktohet nga drejtorët:

- (a) për shërbimet e tyre në shoqëri si drejtorë; dhe
- (b) për (i) çdo shërbim tjetër që ata kryejnë për shoqërinë ose (ii) çdo post ekzekutiv ose punësim pranë shoqërisë ose pranë çdo subjekti që është shoqëri e grupit.

22.3 Në zbatim të statutit, paga e drejtorit:

- (a) mund të jetë çdo lloj forme;
- (b) mund të përfshijë çdo lloj marrëveshjeje në lidhje me pagesën e pensionit, shpërblimeve për vjetërsi pune, përfitimeve në rast vdekjeje, sëmundjeje apo aftësie të kufizuar, në lidhje me atë person.

22.4 Nëse nuk vendoset ndryshe nga drejtorët, shpërblimi i drejtorëve akumulohet nga dita në ditë.

22.5 Drejtorët nuk japin llogari ndaj shoqërisë për shpërblimin që ata marrin si drejtorë ose si nëpunës apo punëmarrës të tjerë të shoqërisë, të shoqërive të grupit ose të subjekteve të tjera ku shoqëria zotëron interesa dhe marrja e këtyre përfitimeve nuk e shkualifikon një person nga të qenit drejtor i shoqërisë.

23. Shpenzimet e drejtorëve

Shoqëria mund të paguajë shpenzimet e arsyeshme që drejtorët (duke përfshirë drejtorët alternativ) dhe sekretari i shoqërisë (nëse ka të tillë të emëruar) kryen në mënyrë të justifikuar në lidhje me pjesëmarrjen në:

- (a) mbledhjet e drejtorëve ose të komiteteve të drejtorëve;
- (b) asamblatë e përgjithshme; ose
- (c) në mbledhje të veçanta të zotëruesve të aksioneve ose titujve të shoqërisë, ose në lidhje me ushtrimin e tagrave të tyre dhe përmbushjen e përgjegjësisë të tyre në lidhje me shoqërinë.

Pjesa 3

Aksionet dhe Shpërndarjet

24. Të gjitha aksionet shlyhen plotësisht

- 24.1 Asnjë aksion nuk emetohet për më pak se e gjithë vlera nominale e tij dhe e çdo primi që duhet t'i paguhet shoqërisë përkundrejt emetimit të tij.
- 24.2 Kjo nuk vlen për aksionet e marra për formimin e shoqërisë nga nënshkruesit e aktit të themelimit të shoqërisë.
- 25. Tagri për të emetuar klasa të ndryshme aksionesh me të drejta të ndryshme
- 25.1 Në zbatim të statutit, por pa cenuar të drejtat që u bashkëngjiten aksioneve ekzistuese, shoqëria mund të emetojë aksione me të drejtat ose kufizimet që përcaktohen me vendim të zakonshëm të anëtarëve.
- 25.2 Shoqëria mund të emetojë aksione që mund të riblihen, ose janë objekt riblerjeje, sipas zgjedhjes së shoqërisë ose të zotëruesit të aksionit, dhe drejtorët mund të përcaktojnë kushtet dhe mënyrën e riblerjes së këtyre aksioneve.
- 25.3 Në rast se të drejtat dhe detyrimet që u bashkëngjiten aksioneve përcaktohen me vendim të zakonshëm të anëtarëve ose nga drejtorët në zbatim të këtij statuti, ato të drejta dhe kufizime zbatohen sidomos në vend të të drejtave ose kufizimeve që do të ishin zbatuar me anë të Ligjit në mungesë të dispozitave në statutin e shoqërisë, njësoj sikur ato të drejta dhe kufizime të ishin të përcaktuara në statut.

26. Certifikatat e aksioneve

- 26.1 Shoqëria duhet të nxjerrë për çdo aksionar, pa pagesë, një apo më shumë certifikata në lidhje me aksionet e zotëruara nga secili aksionar.
- 26.2 Çdo certifikatë duhet të specifikojë:
 - (a) numrin dhe klasën e aksioneve për të cilat është lëshuar;
 - (b) vlerën nominale të atyre aksioneve;
 - (c) që aksionet janë shlyer plotësisht; dhe
 - (d) çdo numër të veçantë që u është caktuar atyre.
- 26.3 Nuk mund të lëshohen certifikata për aksionet e më shumë se një klase.

26.4 Certifikatat:

- (a) duhet të mbajnë vulën e shoqërisë, ose
- (b) të nënshkruhen në përputhje me Ligjin për Shoqëritë.

27. Transferimi i aksioneve

- 27.1 Nuk mund të bëhet dhe regjistrohet transferimi i aksioneve pa miratimin e anëtarit ose anëtarëve që zotërojnë shumicën e vlerës nominale të aksioneve të emetuara në momentin përkatës, dhe që kanë të drejtën për të votuar në asamblatë e përgjithshme të shoqërisë, dhe drejtorët janë të detyruar të miratojnë një transferim që e ka marrë këtë miratim.
- 27.2 Aksionet mund të transferohen me anë të një dokumenti transferimi në një format të zakonshëm ose në çdo lloj formati të miratuar nga drejtorët, i cili nënshkruhet nga ose në emër të transferuesit.
- 27.3 Nuk aplikohet tarifë për regjistrimin e dokumentit të transferimit ose të çdo dokumenti tjetër në lidhje me kalimin e pronësisë mbi aksionet.
- 27.4 Shoqëria mund të arkivojë çdo dokument transferimi të regjistruar.
- 27.5 Transferuesi mbetet zotëruesi i aksionit deri në momentin që emri i marrësit të transferimit regjistrohet në regjistrin e anëtarëve si zotërues i atij aksioni.

Dividendët dhe shpërndarje të tjera të fitimeve

28. Procedura për deklarimin e dividendëve

Drejtorët dhe/ose aksionarët (me vendim të zakonshëm) mund të deklarojnë dividendët dhe/ose të vendosin të paguajnë dividendë të përkohshëm.

29. SHPËRNDARJET JO-CASH

- 29.1 Në zbatim të kushteve për emetimin e aksionit në fjalë, shoqëria mundet, me vendim të zakonshëm të anëtarëve ose me vendim të drejtorëve, të vendosë të paguajë të gjithën apo një pjesë të dividendit ose të shpërndarje të tjera të fitimeve të pagueshme në lidhje me një aksion, duke transferuar aktive jo-cash me vlerë ekuivalente (duke përfshirë pa kufizim, aksionet ose titujt e tjerë në shoqëri).
- 29.2 Për qëllime të pagesës së shpërndarjeve jo-cash, drejtorët mund të ndërmarrin çdo lloj mase që gëzojnë të përshtatshme në rastet kur lindin vështirësi lidhur me shpërndarjen e fitimeve, duke përfshirë:
- (a) caktimin e vlerës së aktiveve;
 - (b) kryerjen e pagesës cash të marrësi i shpërndarjes në bazë të asaj vlere me qëllim rregullimin e të drejtave të marrësit; dhe
 - (c) duke i kaluar aktivet në kujdestari.

30. Shpërndarja e fitimit të gatshëm në rastin e prishjes së shoqërisë

Nëse shoqëria prishet, likuiduesi mundet që me vendim të jashtëzakonshëm të shoqërisë ose sipas çdo autorizimi tjetër të kërkuar nga Ligji, të ndajë mes anëtarëve vlerën faktike të një pjese apo të gjithë aktiveve të shoqërisë, dhe mund të propozojë për këtë qëllim vlerën

e aktiveve dhe të përcaktojë sesi do të bëhet shpërndarja mes anëtarëve ose klasave të ndryshme të anëtarëve. Likuiduesi mundet që me autorizimin përkatës të kalojë të gjitha apo një pjesë të aktiveve në kujdestari në dobi dhe përfitim të anëtarëve, që ai/ajo vendos me autorizim, por asnjë anëtar nuk do të jetë i detyruar të pranojë aktive të ngarkuara me detyrim.

Kapitalizimi i fitimeve

31. Tagri për të kapitalizuar dhe shpërndarja e shumave të kapitalizuara

- 31.1 Në zbatim të statutit, drejtorët, nëse janë të autorizuar me vendim të zakonshëm të anëtarëve, mund:
- (a) të vendosin të kapitalizojnë fitimet e shoqërisë (pavarësisht nëse ato janë apo jo të disponueshme për t'u shpërndarë) të cilat nuk nevojiten për pagesën e dividendit preferencial, ose çdo shumë që është gjendje në llogarinë e primit aksionar të shoqërisë ose në rezervat e kapitalit të shoqërisë; dhe
 - (b) të shpërndajnë çdo shumë që ata vet vendosin të kapitalizojnë ("shuma e kapitalizuar") te personat që kualifikohen për ta përfituar atë shumë njësoj sikur kjo të ishte shpërndarë përmes dividendit ("personat e kualifikuar") dhe në të njëjtat raporte.
- 31.2 Shumat e kapitalizuara duhet të shpërndahen:
- (a) te personat e kualifikuar; dhe
 - (b) në të njëjtat raporte siç do të ishte shpërndarë dividendi tek ata.
- 31.3 Çdo shumë e kapitalizuar mund të shpërndahet përmes shlyerjes së aksioneve të reja me vlerë nominale të barabartë me shumën e kapitalizuar që në atë kohë janë të përcaktuara si plotësisht të pagueshme ndaj personit të kualifikuar, ose siç mund të udhëzohet dhe kërkohet nga ky person.
- 31.4 Shuma e kapitalizuar që është shpërndarë nga fitimet e diponueshme për t'u shpërndarë, mund të përdoret për të paguar tituj të shoqërisë që në atë kohë janë të përcaktuara si plotësisht të pagueshme ndaj personit të kualifikuar, ose siç mund të udhëzohet dhe kërkohet nga ky person.
- 31.5 Në zbatim të statutit, drejtorët mund:
- (a) t'i aplikojnë shumat e kapitalizuara në përputhje me nenet 31.3 dhe 31.4 pjesërisht në një mënyrë dhe pjesërisht në mënyrën tjetër;
 - (b) të marrin masat që gjykojnë të përshtatshme për të trajtuar aksionet ose titujt që shpërndahen në mënyrë të pjesshme sipas këtij neni (duke përfshirë lëshimin e certifikatave të pjesshme ose kryerjen e pagesave cash); dhe
 - (c) të autorizojnë çdo person të lidhë marrëveshje me shoqërinë në emër të të gjithë personave të kualifikuar, e cila është detyruese për ta në lidhje me shpërndarjen e aksioneve dhe titujve te ata, sipas këtij statuti.

Pjesa 4

Vendimmarrja nga aksionarët

32. Kufizimi i efektit të kësaj pjese 4

32.1 Asgjë në këtë pjesë 4 të këtij statuti nuk ndikon në tagrin apo mundësinë e shoqërisë ose anëtarëve të saj që të miratojnë vendime apo rezoluta në përputhje me Ligjin për Shoqërinë ose legjislacionin e përgjithshëm.

33. Vendimet e aksionarëve

33.1 Vendimi i anëtarëve të shoqërisë mund të miratohet:

(a) si vendim me shkrim (nenet 34-deri 36); ose

(b) në mbledhjen e anëtarëve (neni 37).

33.2 Vendimi i zakonshëm i anëtarëve të shoqërisë është një vendim që miratohet me shumicë të thjeshtë të anëtarëve. Vendimi i jashtëzakonshëm i anëtarëve të shoqërisë është një vendim që miratohet me shumicën e anëtarëve që zotërojnë jo më pak se 75% të kapitalit aksionar të zakonshëm.

33.3 Çdo gjë që mund të bëhet me vendim të zakonshëm të anëtarëve mund të bëhet edhe me vendim të jashtëzakonshëm.

33.4 Kur një vendim me shkrim është vendim i jashtëzakonshëm, atëherë në vendim duhet të përcaktohet se ai është propozuar si vendim i jashtëzakonshëm dhe në këtë rast ai mund të miratohet vetëm si vendim i jashtëzakonshëm.

33.5 Kur një vendim duhet të miratohet në mbledhje si vendim i jashtëzakonshëm, njoftimi për mbledhjen duhet të përmbajë tekstin e vendimit dhe të përcaktojë qëllimin e propozimit të vendimit si vendim i jashtëzakonshëm, dhe në këtë rast vendimi mund të miratohet vetëm si vendim i jashtëzakonshëm.

34. Vendimet me shkrim

34.1 Vendimi me shkrim i anëtarëve mund të propozohet nga drejtorët ose të kërkohet nga anëtarët.

34.2 Vendimi me shkrim nuk mund të përdoret për të shkarkuar ekspertët kontabël përpara mbarimit të mandatit të tyre.

34.3 Për shkarkimin e drejtorëve duhet të përdoret procedura sipas nenit 21, dhe vendimi me shkrim sipas këtyre neneve 34 deri 36 nuk mund të përdoret për shkarkimin e drejtorëve.

35. Vendimet me shkrim të propozuara nga drejtorët

35.1 Vendimi me shkrim i propozuar nga drejtorët duhet të dërgohet ose ti paraqitet çdo anëtar i kualifikuar me mënyrat e mëposhtme:

(a) duke dërguar kopje të vendimit (nëse është e mundur) te të gjithë anëtarët e kualifikuar në të njëjtën kohë, qoftë në formë shkresore ose elektronikisht; ose

(b) ose duke qarkulluar të njëjtën kopje të vendimit (nëse kjo është e mundur pa shkaktuar vonesa të tepërta) me radhë te secili anëtar i kualifikuar; ose

(c) në kombinim të pikave a) dhe b) më sipër.

35.2 Kopjet e vendimit duhet të shoqërohen nga një deklaratë që informon anëtarin:

- (a) sesi ta cilësojë miratimin e vendimit; dhe
- (b) për datën deri në të cilën duhet miratohet vendimi në mënyrë që të mos kalohet afatit (që mund të jetë 56 ditë nga data që i është dërguar anëtarëve).

36. Vendimet me shkrim të propozuara nga anëtarët

- 36.1 Anëtarët mund të kërkojnë që vendimi me shkrim të jetë në formën e qarkores. Kjo kërkesë mund të bëhet në formë shkresore ose elektronikisht.
- 36.2 Me marrjen e kësaj kërkesë, shoqëria duhet të dërgojë vendimin te çdo anëtar i kualifikuar në të njëjtën mënyrë që përcaktohet në nenet 35.1 dhe 35.2 më sipër.

37. Vendimet në mbledhjen e anëtarëve

- 37.1 Vendimi i anëtarëve të shoqërisë konsiderohet si i miratuar rregullisht në asamblenë e përgjithshme nëse;
- (a) jepet njoftimi i mbledhjes dhe i vendimit; dhe
 - (b) mbledhja mbahet dhe zhvillohet në përputhje me Ligjin dhe me këtë nen 37.
- 37.2 Drejtorët mund të thërrasin asamblenë e përgjithshme duke dhënë njoftim te të gjithë drejtorët dhe te anëtarët në formë shkresore ose elektronikisht.
- 37.3 Anëtarët mund t'u kërkojnë drejtorëve të thërrasin asamblenë e përgjithshme duke nisur kërkesë në formë shkresore ose elektronikisht, të nënshkruar nga personi ose personat që bëjnë kërkesën, dhe ku të përcaktohet natyra e përgjithshme e çështjeve që do të diskutohen në atë mbledhje.
- 37.4 Njoftimi i asamblesë së përgjithshme të shoqërisë duhet të përmbajë:
- (a) datën dhe orën e mbledhjes;
 - (b) vendin e mbledhjes; dhe
 - (c) natyrën e përgjithshme të çështjeve që do të diskutohen në mbledhje.
- 37.5 Njoftimi i asamblesë së përgjithshme duhet të dërgohet:
- (a) të paktën 14 ditë të plota para (ose më pak, nëse bihet dakord nga anëtarët) nëse nuk kërkohet njoftim i jashtëzakonshëm; ose
 - (b) të paktën 28 ditë të plota para, nëse kërkohet njoftim i jashtëzakonshëm sipas Ligjit ose sipas këtij statuti.
- 37.6 "Ditë të plota" në lidhje me numrin e ditëve në këtë statut, do të thotë që dita e njoftimit dhe dita e mbledhjes nuk llogariten në numrin e ditëve (për sqarim, nëse kërkohet njoftim 14 ditor, njoftimi i dhënë në datën një të atij muaji është njoftim i vlefshëm për mbledhjen që do të mbahet në datën 16 të atij muaji, pra jo për mbledhjen që mbahet në datën 15 të atij muaji).
- 37.7 Njoftimi i jashtëzakonshëm kërkohet për vendimet për shkarkimin e:
- (a) ekspertëve kontabël përpara mbarimit të mandatit të tyre; ose
 - (b) drejtorëve, nëse nuk përdoret procedura sipas nenit 21.

Part5
Rregullat administrative

38. Mjetet komunikimit që përdoren

- 38.1 Në zbatim të këtij statuti, çdo gjë që duhet t'i komunikohet apo dërgohet shoqërisë sipas këtij statuti, mund të komunikohet ose dërgohet në çdo mënyrë të parashikuar nga Ligji për sa i përket atyre dokumenteve ose informacioneve që në bazë të dispozitave të Ligjit janë të autorizuara apo duhet të komunikohen apo dërgohen nga shoqëria apo për shoqërinë.
- 38.2 Në zbatim të këtij statuti, çdo njoftim apo dokument që duhet t'i dërgohet një drejtori në lidhje me marrjen e vendimeve nga drejtorët, mund të dërgohet edhe me mënyrat që ai drejtor ka kërkuar që t'i dërgohen këto njoftime apo dokumente herë pas here.
- 38.3 Drejtori mund të bjerë dakord me shoqërinë që njoftimet ose dokumentet që i dërgohen atij drejtori në një mënyrë të posaçme, të konsiderohen se janë marrë në dorëzim brenda një kohe të caktuar nga momenti i dërgimit, dhe që kjo kohë e caktuar të mos jetë më pak se 48 orë.

39. Vula e shoqërisë dhe delegimi nga drejtorët i tagrit për të nënshkruar në emër të shoqërisë

- 39.1 Vula mund të përdoret vetëm me tagrin e drejtorëve.
- 39.2 Drejtorët mund të vendosin mënyrën dhe formën në të cilën do të përdoret vula.
- 39.3 Nëse nuk vendoset ndryshe nga drejtorët, nëse shoqëria ka një vulë të përbashkët dhe ajo vendoset në një dokument, dokumenti duhet gjithashtu të nënshkruhet nga të paktën një nënshkrues i autorizuar.
- 39.4 Për qëllime të këtij neni, nënshkrues i autorizuar është:
- (a) çdo drejtor i shoqërisë;
 - (b) sekretari i shoqërisë (nëse ka); ose
 - (c) çdo person i autorizuar me prokurë të përgjithshme ose të posaçme për qëllime të nënshkrimit të dokumenteve në të cilat do të vendoset vula.
- 39.5 Shoqëria mund të ushtrojë të gjitha kompetencat që i jepen nga Ligji në lidhje me pasjen e një vule zyrtare dhe këto kompetenca u jepen drejtorëve.
- 39.6 Të gjitha kontratat, marrëveshjet, aktet dhe dokumentet (përfshirë aktet noteriale dhe prokurat e përgjithshme e të posaçme) mund të nënshkruhen në emër të shoqërisë nga secili prej drejtorëve. Secili prej drejtorëve të Shoqërisë mund të delegojë tagrin e nënshkrimit të çdo person tjetër për të nënshkruar dhe bërë të vlefshme të gjitha kontratat, marrëveshjet, aktet dhe dokumentet (me përjashtim të prokurave të përgjithshme ose të posaçme) në emër të shoqërisë, herë pas here.
- 39.7 Delegimi i tagrit të nënshkrimit që jepet sipas këtij neni 39, duhet të bëhet me shkrim dhe një kopje e të gjitha dokumenteve të delegimit të tagrit të nënshkrimit dorëzohet te sekretari i shoqërisë ose te përfaqësuesi i tij/saj.

40. Ndalimi i të drejtës për të inspektuar librat dhe regjistrat kontabël

Përveçse kur parashikohet me ligj apo kur autorizohet nga drejtorët ose me vendim të

zakonshëm të anëtarëve, asnjë person nuk ka të drejtë të inspektojë librat dhe regjistrat kontabël të shoqërisë apo dokumente të tjera kontabël, thjesht për faktin se është aksionar.

41. Provigjonet për punëmarrësit në rastin e prishjes së shoqërisë

Drejtorët mund të vendosin të japin provigjone në dobi të personave të punësuar apo të ish punësuar nga shoqëria ose nga degët e saj (përveç drejtorëve ose ish drejtorëve ose drejtorët e konsideruar si të tillë me ligj) në lidhje me prishjen ose transferimin e të gjithë apo një pjese të aktivitetit të shoqërisë ose të degës së saj te një person tjetër.

Dëmshpërblimi dhe shpenzimet e drejtorëve dhe të nëpunësve të lartë

42. Dëmshpërblimi dhe shpenzimet

42.1 Në zbatim të nenit 42.4, një drejtor apo nëpunës i lartë i shoqërisë ose i një shoqërie të lidhur dëmshpërblehet nga aktivi i shoqërisë për:

- (a) çdo detyrim që i ngarkohet drejtorit ose nëpunësit të lartë në lidhje me pakujdesinë, mospërbushjen, shkeljen e detyrës ose shkeljen e besimit në lidhje me shoqërinë ose shoqërinë e lidhur;
- (b) çdo detyrim që i ngarkohet drejtorit ose nga nëpunësit të lartë në lidhje me aktivitete të shoqërisë ose të shoqërisë së lidhur në kapacitetin e tij si i kujdestar i një skeme pensioni profesional (sipas përkufizimit në seksionin 235(6) të Ligjit); dhe
- (c) çdo detyrim tjetër që i ngarkohet drejtorit ose nëpunësit të lartë të shoqërisë ose të shoqërisë së lidhur.

42.2 Shoqëria mund të financojë shpenzimet e drejtorit apo nëpunësit përkatës për qëllimet e lejuara nga Ligji dhe mund të bëjë çdo gjë për t'i dhënë mundësinë drejtorit apo nëpunësit përkatës që të shmangin kryerjen e këtyre shpenzimeve siç parashikohet nga Ligji.

42.3 Asnjë drejtor apo nëpunës nuk mban përgjegjësi ndaj shoqërisë ose anëtarëve për përfitimet që merr sipas këtij neni dhe marrja e këtyre përfitimeve nuk shkualifikon asnjë person për të qenë apo për t'u bërë drejtor ose nëpunës i shoqërisë.

42.4 Ky statut nuk autorizon asnjë dëmshpërblim që ndalohet apo deklarohet i pavlefshëm nga dispozitat e Ligjit për shoqëritë ose nga dispozita të ligjeve të tjera.

42.5 Në këtë statut:

- (a) shoqëritë janë të lidhura nëse njëra është degë e tjetrës ose të dyja janë degë të të njëjtës shoqëri; dhe
- (b) "drejtor ose nëpunës përkatës" është çdo drejtor ose nëpunës ose çdo ish drejtor apo ish nëpunës i shoqërisë ose i shoqërisë së lidhur.

Përlidhur:

Daniela Demiri



KONFIDENCIALE

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER LORIANA A. ROBO**



V2021050250235540995

**DATE 01/06/2021
NR REP 2844**



VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 01/06/2021, para meje Noterit LORIANA A. ROBO, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.5, ISMAIL QEMALI, NR.27, NR.1, NR.1, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES:

Daniela Demiri, atësia Myzafer, amësia Drita, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë 1001 Njesia Bashkiake Nr. 10 Myslym Shyri 124/2 2 27, lindur më 23/11/1983, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 025734119 dhe nr. personal I36123030B.

Përkthyesja është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur “Statuti i Bechtel Limited”, nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noterit.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”,” në Republikën e Shqipërisë unë Noteri vërtetoj nënshkrimin e përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

LORIANA A. ROBO

